




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primjeno/Pradato Received/Delivery	13.12.2022	2 viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtetj.-a Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHICK	8021/2022		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.976/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.976/2022 të datës 04.11.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson avokat nga Gjilani, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet ankesa me numër A.nr.976/2022 e datës 04.11.2022 e parashtruar nga ankuesi *si e pabazuar.*

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokoli 2112-1/2022 i datës 07.10.2022 të Udhëheqësit të Divizionit për Burime Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

A r s y e t i m

Ankuesi, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e regjistruar nën shenjën A.nr.976/2022, kundër Vendimit me numër protokoli 2112-1/2022 të datës 07.10.2022 të Udhëheqësit të Divizionit për Burime Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetim jo të drejtë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa kjo e fundit më datë 14.11.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6705/2022 të datës 04.11.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 02.11.2022; Vendimin me numër protokollit 2112-1/2022 të datës 07.10.2022 të..... Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; Njoftimin e datës 30.08.2022 dhe 12.09.2022 nga Divizioni i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; Listën e vlerësimeve përfundimtare e datës 22.09.2022; Emailin e datës 30.08.2022 nga Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për ankuesin; Konkursin me Nr.Reference: RN00009597 për pozitën Zyrtar për Pensione; Zarin e datës 02.11.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.11.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 14.11.2022; Konkursin me Nr. Reference: RN00008025 për pozitën Zyrtar për Pensione; Njoftimin e datës 20.01.2022 për anulimin e procedurës; Lista e aplikantëve; Ankesën e datës 29.09.2022 të ankuesit në Divizionin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; Kërkesën për punësim të ankuesit e pranuar me datë 23.08.2022 nga Divizioni i Burimeve Njerëzore; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Diplomën e datës 09.06.1980; Certifikatën e Vendbanimit me Nr. B 10399406; Certifikatë e muajit dhjetor 2011; Certifikatën me Nr. 11633/30 e datës 29.06.2000; Vërtetimin me Nr.Port:290 i datës 24.02.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 19.01.2021, Njoftimi i datës 30.08.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të MFPT (i shkarkuar përmes SIMBNJ), Njoftimi i datës 12.09.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të MFPT (i shkarkuar përmes SIMBNJ), lista e rezultatit të vlerësimit përfundimtar e datës 22.09.2022 (e shkarkuar përmes SIMBNJ) dhe lista e rezultatit të vlerësimit përfundimtar e datës 29.09.2022 (e shkarkuar përmes SIMBNJ) pas ushtrimit të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat e lëndës, ka konstatuar se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, SEPSE:

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji gjen së Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (tutje MFPT) më datë 19.01.2022 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00008025 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "Zyrtar i Pensioneve", klasa profesional 3, me koeficienti nëntë (9), katër (4) pozita për vendet e punës në Viti, Kaçanik, Deçan dhe Shtërpçë. I njëjti konkurs sipas Njoftimit të datës 20.01.2022 të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve është anuluar për shkak të gabimit në përcaktimin e koeficientit të pagës për këtë pozitë.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, po për pozitë të njëjtë më datë 01.08.2022 ka shpallur Konkursin për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00009597, me koeficient shtatë (7) të pagës) katër (4) pozita për vendet e punës në Viti, Kaçanik, Deçan dhe Shtërpçë. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi përmes kërkesës fizike të dorëzuar drejtpërdrejtë në Divizionin e Burimeve Njerëzore të MFPT-së më datë 23.08.2022.

Në fazën e shqyrtimit paraprak Njësia e Burimeve Njerëzore të MFPT-së më datë 30.08.2022 ka njoftuar individualisht ankuesin se i njëjti nuk është përfshirë në fazat tjetra të kësaj procedure rekrutimi me arsyetimin se: *aplikimi për pozitën zyrtar i pensioneve ka qenë i hapur përmes sistemit elektronik, dhe dosja juaj fizike nuk mund të ngarkohet në sistem.*

Ankuesi më datë 29.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2112/2022 në Divizionin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa kjo e fundit me

Vendimin me numër protokolli 2112-1/2022 të datës 07.10.2022 ka refuzuara si të palejuar ankesën e ankuesit, me arsyetimin se ankesa është parashtruar në kundërshtim me afatet e përcaktuar me nenin 45 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe së ankuesi kishte aplikuar në mënyrë fizike ku dhe ngarkimi i aplikacionit në sistemin elektronik ishte i pamundur, dhe mbi këtë bazë ankuesi ishte njoftuar së nuk mund të përfshihet në fazat tjera të procedurës së rekrutimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokolli 2112-1/2022 të datës 07.10.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të MFPT-së, pretendon se konkursi i parë është anuluar vetëm më njoftim e jo me akt administrativ, duke theksuar së në rastet kur kemi të bëjmë me përfitimin, realizimin dhe shuarjen e një të drejtë personale njoftimi nuk është akt juridik sepse i mungojnë elementet bazë formalo-juridike, ndërsa lidhur me konkursin e dytë pretendon së është i kundërligjshme dhe përshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale.

Në kuptim të ligjshmërisë, Kolegji i Këshillit ka analizuar Vendimin me numër protokolli 2112-1/2022 të datës 07.10.2022 të Udhëheqësit të Divizionit për Burime Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe si rrjedhojë ka konstatuar së Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të MFPT-së ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike, duke zbatuar drejtë dispozitat ligjore, pasi që bazuar në legjislacionin në fuqi për zyrtaret publikë, procedurat e konkurrimit dhe emërimit të nëpunësve civil realizohen vetëm përmes sistemit elektronik qendror me emërtimin SIMBJN i aplikueshëm për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht mbi këtë bazë, Kolegji ju referua nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: "...2. SIMBNJ-ja është një sistem qendror elektronik për të gjitha institucionet publike të Kosovës. 3. SIMBNJ-ja përfshin: 3.1. bazën unike të të dhënave profesionale dhe të dhënave të tjera për marrëdhëniet e punës për çdo punëtor të një institucioni publik, përfshirë këtu edhe historikun e tyre të punësimit; 3.2. modulet aplikative për menaxhimin e burimeve njerëzore, duke përfshirë menaxhimin e sistemit të pagave dhe shpërblimeve; dhe 3.3. ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit dhe emërimit për nëpunësit civilë, nëpunësit e shërbimeve publike dhe nëpunësit administrativ dhe mbështetës. 4. Çdo institucion është i obliguar që të gjitha proceset, veprimet dhe procedurat lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore t'i kryejë përmes SIMBNJ...", si dhe nenit 11 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin shprehimisht thuhet se: "Kandidatët për një konkurrim, plotësojnë aplikacionin në mënyrë elektronike me përmbajtje sipas nenit 12 të kësaj rregulloreje". Ndërlidhur më këtë edhe në pikën 11 të Konkursit me numër reference RN00009597 është përcaktuar mënyra e aplikimit vetëm përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>), ndërsa bazuar në provat e lëndës rrjedhë së ankuesi nuk ka aplikuar në mënyrë elektronike gjegjësisht përmes SIMBNJ-së por i njëjti kishte parashtruar kërkesë të punësimit në formë fizike dhe si pasojë e kësaj nuk është përfshirë në listën e ngushtë të datës 12.09.2022.

Bazuar në nenin 45 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është përcaktuar se: "...Brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme..." kurse sipas prova të lëndës rezulton së ankuesi kundër njoftimit të pranuar me datë 30.08.2022 (i dëshmuar përmes kopjes se emailit të dërguar nga ankuesi) ka parashtruar ankesë më datë 29.09.2022, rrjedhimisht jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat ligjore si me lart.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimit ankimor të ankuesit se konkursi i datës 19.01.2022 është anuluar vetëm më njoftim e jo me akt administrativ, Kolegji bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës ka gjetur se Konkursi me numër reference RN00008025 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "Zyrtar i Pensioneve", është shpallur më datë 29.01.2022 duke vendosur periudhën e aplikimit nga data 03.02.2022 deri me 10.02.2022, ndërsa, anulimi i këtij konkursi është bërë një ditë pas publikimit (datë 30.01.2022) pra ende pa filluar procedura e aplikimit, kështu që mbi këtë bazë Kolegji konstaton se me njoftimin e datës 30.01.2022 nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik personal, andaj në kuptim të nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative Kolegji vlerëson se ky pretendim ankimor i ankuesit është i papranueshëm.

Theksuar si më lart, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.976/2022

Avdyl BEKTESHI

Avdyl Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT-së;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MFPT-së; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.